



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 58
Prishtinë, më 20 prill 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 20 PRILL 2012**

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, **Jakup KRASNIQI**, ndërsa i ndihmoi nënkryetari **Xhavit HALITI**.

Kryetari, deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë.

Në vazhdim, Kuvendi i filloi punimet me këtë

Rend dite:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i dytë i Projektkodit Penal të Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Halit Krasniqi, Visar Ymeri, Ismet Beqiri, Ardian Gjini, Zenun Pajaziti, Liburn Aliu, Rita Hajzeraj-Beqaj, Ganimete Musliu, Ali Sadriu, Sala Berisha-Shala, Sabri Hamiti, Shaip Muja, Alma Lama, Teuta Haxhiu, Arben Gashi, si dhe kryeministri Hashim Thaçi, ministri Besim Beqaj, dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Time Kadriaj parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me vendimin që femrat të trajtohen nga mjeket femra dhe sa mjete janë ndarë për punësimin e gjinekologeve dhe mjekeve tjera femra?

Në mungesë të ministrit, në këtë pyetje u përgjigj zv.kryeministri Hajredin Kuçi.

Deputetja Blerta Deliu-Kodra parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me veprimet që ka ndërmarrë Ministria që ai drejton për zbardhjen e fatit të të pagjeturve.

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Blerta Deliu-Kodra.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtroi pyetje për zv.kryeministrin Hajredin Kuçi lidhur me atë se kur do t'i qaseni veriut të vendit me veprime konkrete?

Zv.kryeministri Hajredin Kuçi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi parashtroi pyetje për ministrin e Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi në lidhje me atë se kur do t'i qaseni veriut të vendit me veprime konkrete?

Ministri Bajram Rexhepi, iu përgjigj pyetjes së deputetes Donika Kadaj-Bujupi.

Deputetja Albulena Haxhiu parashtroi pyetje për kryeministrin Hashim Thaçi lidhur me atë se me gjithë deklaratimet tuaja, ju lejoni aktivitetet e strukturave ilegale në organizimin e zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë, dhe me çfarë baze ligjore dhe kushtetuese jeni mbështetur kur keni deklaruar se do lehtësoni pjesëmarrjen në votim në organizimin e zgjedhjeve të shtetit armik serb.

Kryeministri nuk ishte prezent në sallë.

Deputetja Alma Lama parashtroi pyetje për ministren Vlora Çitaku lidhur me rezultatin e vizitës në SHBA përsa i përket procesit të integrimi evropian.

Ministrja nuk ishte prezent në sallë.

Deputeti Xhevdet Neziraj parashtroi pyetje për ministrin Besim Beqaj në lidhje me numrin e pjesëtarëve të komunitetit egjiptas të punësuar në ndërmarrjet publike(KEK dhe PTK).

Ministri Besim Beqaj, iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhevdet Neziraj.

Deputeti Xhevdet Neziraj parashtroi pyetje për ministrin Dardan Gashi lidhur me veprimet që është duke i bërë Ministria që ai drejton për vendbanimet joformale pasi që një numër i madh i njerëzve janë duke banuar në kushte joadekuate të banimit.

Ministri Dardan Gashi iu përgjigj pyetjes së deputetit Xhevdet Neziraj.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektkodit Penal i Republikës së Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

Raportin e Komisionit funksional për Legjislacion, e arsyetoi kryetari e këtij Komisioni, deputeti Arben Gashi.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 6A, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24A, 25A, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 44, 45, 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 54, 56, 57 dhe amendamenti nr. 58.

Amendamenti nr. 5, me kërkesë të deputetëve, u rivotua.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet nr. 5, 53 dhe 55.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Alma Lama, Arben Gashi, Xhavit Haliti, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Behar Selimi, Bekim Haxhiu dhe zv.kryeministri Hajredin Kuçi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektkodin Penal, me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	76,
Kundër-----	9,
Abstenime-----	1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektkodin Penal të Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për fshatin Hoçë e Madhe

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe.

Raportin e Komisionit funksional për Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, e arsyetoi kryetari e këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani.

Pastaj, kryetari hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 2, 3A, 4A, 5B, 6A, 7, 8A, 10, 12A, 13 dhe 15.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet nr. 1 dhe 5A.

Qeveria tërhoqi nga votimi amendamentet nr. 9, 11 dhe 14.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Hydajet Hyseni, Liburn Aliu, Daut Haradinaj, Sali Morina, Alma Lama, kryeministri Hashim Thaçi, Nait Hasani dhe ministri Dardan Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 26,
Abstenime----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, miratoi Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Qendrën Historike të Prizrenit

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

Raportin e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor e arsyetoi kryetari e këtij Komisioni, deputeti Nait Hasani.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 2A, 3, 4A, 5A, 6, 7A, 8, 9, 10, 12, 13, 14, 15A, 16, 18, 19, 20A dhe amendamenti nr. 22.

Kuvendi nuk miratoi amendamentet nr. 1, 11 dhe 21.

Qeveria tërhoqi nga votimi amendamentet nr. 5B, 7B dhe 17.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Nait Hasani, Hydajet Hyseni, Emin Gërbeshi, ministri Dardan Gashi, kryeministri Hashim Thaçi, Goran Marinković dhe Sabri Hamiti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 56,
Kundër----- 30,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Projektligjin për Qendrën Historike të Prizrenit.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, e arsyetoi kryetari e këtij Komisioni, deputeti, Zenun Pajaziti.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe amendamentin nr. 8.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 69,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme

Kryesuesi i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit funksional raportues për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kryesuesi hodhi në votim amendamentet veç e veç.

Kuvendi miratoi këto amendamente: 1, 2, 3 dhe amendamentin nr. 4.

Pastaj, kryesuesi hodhi në votim Projektligjin me amendamentet e miratuara, në tërësi.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Kryesuesi konstatoi të mbyllur punimet e mbledhjes së sotme, në ora 13:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale